



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Draft Plani i Veprimit për Mekanizmin Koordinues Kundër Dhunës në Familje
në Komunën e Kamenicës
(2024-2026)**

Mars 2024

S h k u r t e s a t :

BE - Bashkimi Evropian

DKA – Drejtoria Komunale e Arsimit

DHBGJ - Dhuna në Baza Gjinore

DHF - Dhuna në familje

NJKDNJ – Njësia Komunale për të drejtat e njeriut

MAPL - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

MM - Memorandum mirëkuptimi

MV - Mbrojtës i Viktimave

OJQ - Organizata Joqeveritare

OSBE - Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë

PK – Policia e Kosovës

PSV - Procedurat standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje

QAP - Qendra e aftësimit profesional

QMF – Qendra e Mjekësisë Familjare

QPS - Qendrat për Punë Sociale

QRK – Qeveria e Republikës së Kosovës

UA - Udhëzim Administrativ

ANJF – Agjencia për Ndihmë Juridike Falas

ZKBGJ - Zyrtarja Komunale për Barazi Gjinore

P ë r m b a j t j a

I. Hyrje

II Analiza e situatës së dhunës në familje në Komunën e Kamenicës

2.1 Pabarazitë gjinore

III. Pasojat më të theksuara të dhunës në familje

3.1 Kriza familjare

3.2 Frika dhe ndërgjegjësimi ulët për çështjet e dhunës në familje

3.3 Mospranimi i dhunës seksuale:

3.4 Probleme lidhur me trashëgiminë

IV. Plani i Veprimit për Mekanizmin Koordinues Kundër Dhunës në Familje në Komunën e Kamenicës

I. Hyrje

“Dhuna ndaj grave në thelb është çështje e pushtetit. Ajo do të përfundojë vetëm kur barazia gjinore dhe fuqizimi i plotë i grave do të behën realitet.” (Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, António Guterres)

Ndonëse, dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje është shkelje e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut¹ dhe përbën goditje të dinjitetit njerëzor, si në gjithë globin edhe në shoqërinë kosovare ajo vazhdon të jetë e përhapur me përmasa mjaftë të mëdha.

Dhuna ndaj grave është manifestim i marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të pushtetit midis burrave dhe grave² dhe me të drejtë konsiderohet pengesa më madhe në realizimin e një bote paqësore, të prosperuar dhe të qëndrueshme. Krahas vështirësive ekonomike, shoqëria jonë po ballafaqohet edhe me një sërë problemesh tjera si: papunësia, lëvizjet demografike, ndryshime të koncepteve mbi vlerat dhe virtytet njerëzore, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në pjesëmarrjen e ulët të gruas në vendimmarrje dhe pabarazisë gjinore.

Duke qene se dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje gjithnjë e më shumë po njihet jo vetëm si shkelje e të drejtave individuale, por edhe si kërcënim për demokracinë, pengesë për zhvillim shoqëror dhe rrezik për paqe të qëndrueshme, pasojat e së cilës tronditin jo vetëm rrethim e ngushtë të familjes por të gjithë shoqërinë, dhe si e tillë kërkon angazhim të gjithë shoqërisë për marrjen e masave të nevojshme për parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje, misioni i OSCE në Kosovë mori iniciativën të përkrahë Mekanizmin Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në hartimin e Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (2024- 2026).

Para së gjithash, Plani i veprimit të MKKDF do të ndikoj në rritjen e bashkëpunimit në mes të qytetarit dhe institucioneve shtetërore, shtyllat e së cilës janë të vendosura në “parandalimin e dhunës, mbrojtjen e viktimave të saj dhe ndjekja penale e dhunuesve”. Ajo synon gjithashtu të ndryshojë mendësitë e individëve duke iu bërë thirrje pjesëtarëve të shoqërisë, në veçanti burrave dhe djemve, të ndryshojnë sjellje.

¹ Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, 1994; <https://ëëë.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/ViolenceAgainstEomen.aspx>, qasur më 1 korrik 2021;

² Këshilli i Europës, Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, preambula, 2011;

Po ashtu, me anë të këtij plani synohet të vendoset një kornizë gjithëpërfshirëse dhe e unifikuar e përpjekjeve institucionale në kuadër të reformimit të sistemit për mbrojtjen nga dhuna në familje.

Masa këto që i referohen fuqizimit të mekanizmave koordinues për reagim dhe bashkëpunim të shpejtë për parandalim dhe mbrojtje efikase të rasteve të dhunës në familje; promovimin e programeve dhe aktiviteteve për fuqizimin e grave, çrrënjosjen e paragjyqimeve e stereotipeve si dhe pasojat e tyre; sigurimi i qëndrueshmërisë së shërbimeve për rehabilitim dhe riintegrim të viktimeve të dhunës në familje.

Plani i veprimit për MKKDFH identifikon çështjet që me prioritet kanë nevojë për ndërhyrje të menjëhershme duke kërkuar bërjen e përpjekjeve maksimale që të sigurohet “Një shoqëri që iu siguron të gjithë shtetaseve të saj, të rritur dhe fëmijë, të jetojnë pa frikë apo kërcënimin e dhunës në familje, që mbron viktimat, vendos kryerësit përpara përgjegjësisë dhe zvogëlon tolerancën e publikut ndaj veprimeve të dhunshme në familje”.³

Realizimi i të drejtave të njeriut, fillon me sigurimin e barazisë, rezultatet e të cilit janë të ndërlidhura në nivel të lartë të produktivitetit për ekonomin, gjendjen sociale dhe zhvillimin e vendit. Plani i veprimit të MKKDFH parashihet të jetë katalizatorë që duke përcaktuar hapat e mëtejme që duhet ndërmerren drejt një strukture koherente për promovim, respektim, mbrojtje dhe luftim të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, të ndikoj në përshpejtimin e investimeve më të mira dhe të shtuara për të drejtat e njeriut për një barazi më të madhe dhe rritje ekonomike në vend. Për më tej, ky plan në vete bënë edhe thirrje për aksion, që të bashkojmë dijet, energjinë, mundësit dhe financat, për realizim të plotë të të drejtave të njeriut, për të rritur mirëqenien dhe eliminimin e kohezionit social në Komunën e Kamenicës.

³ Ministria e Drejtësisë, Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit (2016-2020), 2016;

II Analiza e situatës së dhunës në familje në Komunën e Kamenicës

Dhuna në Familje nuk është një dukuri e re për qytetarët e komunës sonë, por edhe shoqërinë kosovare në përgjithësi. E shprehur në forma dhe intensitete të ndryshme ajo është trashëguar prej së shkuarës, por në ditët e sotme vërehen edhe shumë tipare të reja të shprehjes së saj. Analiza e shkurtër e situatës në Komunën e Kamenicës ka ndihmuar të qartësohet lista e problemeve dhe shkaqeve që i shkaktojnë ato. Shkaqet që çojnë në rritjen e shkallës së Dhunës në Familje janë të shumta, ndërmjet të cilave përmendim:

2.1 Pabarazitë gjinore: Në Kosovë, roli i femrave në proceset e zhvillimit shoqëror, ekonomik dhe politik është shumë i rëndësishëm, ndonëse ende në ditët e sotme ndeshemi me pabarazi gjinore të dukshme apo të fshehura. Pozita e pabarabartë gjinore ndikohet nga shkalla e ulët e punësimit të grave, vështirësitë që kanë në qasje të shërbimeve shëndetësore, niveli i ulët i integritetit të grave në ekonomi dhe numri i vogël i grave në pozitat udhëheqëse në administratën publike.

Në Kosovë është krijuar një bazë e mirë ligjore sa i përket çështjes së barazisë gjinore dhe janë bërë hapa të dukshëm në avancimin e pozitës së grave, ku Komuna e Kamenicës, krahas viteve të mëhershme, ka shënuar progres të dukshëm në avancimin e gruas. Të dhënat paraqesin një përfshirje më të madhe të grave në politikë, në arsim, e sektorë të tjerë. Megjithatë, ende nuk është arritur përfaqësimi i kënaqshëm gjinor, i paraparë në Ligjin për Barazi Gjinore, në të cilin përcaktohet se pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve, në institucione apo në nivel të pushtetit, është 50% me 50%.

Duke pasur parasysh trendet e shkallës së papunësisë, për një pjesë të popullsisë në Komunën e Kamenicës, femra mbetet në pozitë më të pafavorshme krahasuar me meshkujt si në lëmin e punësimit, nivelit të varfërisë, arsimit, si dhe pjesëmarrjen aktive në sferën publike dhe private.

III. Pasoja më të theksuara të dhunës në familje

Dhuna në Familje sjell shumë pasoja në komunitet, të cilat kanë një numër të madh efektesh të padëshiruara:

3.1 Kriza familjare: Avancimi i rolit të femrës në shoqëri dhe pozita e saj në familje ka ndryshuar në kuptimin e pavarësimit më të madh të saj, marrjes së iniciativave, edukimit dhe arsimimit, fakte të cilat kanë ndikuar në ndryshimin e roleve në familje dhe shoqëri. Kriza familjare në periudhën e pas luftës në Kosovë ka shkaqe të ndryshme: lëvizja e popullatës nga fshatrat në qytete, kalimi nga familjet e zgjeruara dhe të mëdha në familje më të vogla. Të tilla ndryshime shihen si faktorë mbrojtës (kur shmanget ndikimi patriarkal prej brezave më të vjetër), por edhe faktorë rreziku njëherësh, si pamundësia e mbrojtjes në rastet e dhunës në familje të nxitura nga papunësia, konfliktet dhe mentalitetit mes gjeneratave, etj.

3.2 Frika dhe ndërgjegjësimi ulët për çështjet e dhunës në familje: Mos raportimi i dhunës në familje nga viktimat është ndër fenomenet më të shpeshta, pasi konsiderohet turp dhe një çështje që nuk duhet të dalë jashtë mureve të shtëpisë.

3.3 Mospranimi i dhunës seksuale: Për shkak të stigmës dhe ndëshkimit vërehet mos raportim i dhunës nga ana e Viktimave dhe për këtë dhuna seksuale rezulton më pak e raportuar ose nuk ekziston fare në krahasim me dhunën fizike.

3.4 Probleme lidhur me trashëgiminë: Sa i përket procedurave të shqyrtimit të trashëgimisë, shumë herë ndodh që gruaja nuk njoftohet fare ose përjashtohet nga diskutimi për masën trashëgimore, qoftë në pozitën e bashkëshortes, nënës apo motrës dhe në këtë mënyrë diskriminohet. Veç kësaj, organi kompetent komunal për mbajtjen e librit amzë të vdekjeve ka për detyrë që në aktvdekje të shënojë emrat e trashëgimtarëve femra dhe meshkuj dhe asesi të mos i diskriminojë femrat.

Plani i Veprimit të Mekanizmit Komunal Kundër Dhunës në Familje për Komunën e Kamenicës synon të:

- Të punojë në parandalimin e dhunës në familje dhe ngritjen e vetëdijes tek komuniteti për aspektet negative të këtij fenomeni;
- Të përmirësojë/ndërtojë sistemin e grumbullimit dhe shkëmbimit të të dhënave në mes të akterëve relevant;
- Të fuqizojë mekanizmat për reagim sa më të shpejtë ndaj rasteve të dhunës në familje dhe të përmirësojë koordinimin në mes anëtarëve të grupit gjatë menaxhimit të tyre;
- Të bëjë avokim dhe monitorim të zbatimit të politikave si dhe të sugjerojë ndryshime bazuar në përvojat më të mira nga terreni.

Plani i Veprimit të MKKDFH bazohet në tri fusha të veprimit, si:

- Vetëdijësimi dhe Parandalimi
- Mbrojtja dhe Koordinimi
- Fuqizimi ekonomik, rehabilitimi dhe riintegrimi

Plani i Veprimit për Mekanizmin Koordinues Kundër Dhunës në Familje në Komunën e Kamenicës

Komuna Kamenicë

Viti: 2024 - 2026

Objektivi strategjik - I - Identifikimi dhe parandalimi i dhunës nëpërmjet edukimit dhe vetëdijesimit

Treguesi: përqindja e grave, burrave, vajzave e djemve të cilët besojnë se dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave janë të pa tolerueshme.

Rezultati i synuar: Të rritet çdo vit nga 10 - 30 % numri i grave, vajzave, burrave e djemve të cilët besojnë se dhuna është e pa tolerueshme.

Objektivi specifik: Ndryshimi i sjelljeve, qëndrimeve, roleve dhe stereotipave gjinore që justifikojnë dhunën

Treguesi: numri i rasteve të dhunës në familje të denoncuar/raportuara nga pala e tretë

Rezultati i synuar: Rritja e raportimit të rasteve nga pala e tretë

Aktiviteti	Veprimet	Institucioni të cilit i kërkohet përkrahje /bashkëpunim	Data e zbatimit	Kosto	Burimi i Financimit	Rezultati i dëshiruar/ i pritshëm	Dokumenti Strategjik është në pajtueshmëri aktiviteti në fjalë
1. Fushata vetëdijesuese për dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave.	<ol style="list-style-type: none">Organizimi i ligjëratave nga MKKDHF në viset rurale dhe urbane.Përmes DKA të informohen gjithë nxënësit nga kl.VI-XII	MKKDHF Policia e Kosovës NJKDNJ Drejtoritë e Komunës	2024 2025 2026	500	Komuna Donatorët	Rritja e numrit të personave të informuar për pasojat e dhunës në familje	Konventa e Stambollit (kapitulli III, nenet 12 dhe 13)

	<p>për pasojat e dhunës në familje dhe rëndësinë e raportimit derisa këto tema të jenë pjesë e plan-programit shkollor.</p> <p>3. Organizimi i emisioneve, debateve në media për dhunën në familje.</p> <p>4. Përfshirja e institucioneve fetare në fushatën vetdijësuese.</p>	OJQ Bashkësië ftetare					
<p>2. Organizimi i Javës për të drejtat e viktimave, me fokus të veçantë viktimat e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, siç parashikohen me Konventën e Stambollit</p>	<p>Realizimi i një aktiviteti vetëdijësues cdo vit për të drejtat e viktimave të dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në bazë gjinore.</p> <p>Përgatitja e fletëpalosjeve dhe postereve me mesazhe dhe informacione më të detajuara për të drejtat e viktimave.</p>	MKKDHF NJDNJ	2024 2025 2026	500e per cdo vit	Donatorët Komuna	Më shumë informacion dhe vetëdijësim mbi të drejtat e viktimave/të mbijetuarave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave	Java për të drejtat e viktimave Konventa e Stambollit (kapitulli IV nenet 18, 19)

<p>3. Sesione informuese me grupe të ndryshme të grave, vajzave, burrave, djemve, mbi ekzistencën e mekanizmave koordinues për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave në nivelin lokal si dhe mbrojtjes, trajtimit dhe qasjes në drejtësi përmes këtyre mekanizmave.</p>	<p>Realizimi i takimeve me grupe të ndryshme të interesit për tu informuar me rolin e mekanizmit lokal</p>	<p>MKKDHF NJDNJ Drejtoritë Komunal e</p>	<p>25 Nëntor deri më 10 dhjetor 2024 2025 2026</p>	<p>500e per cdo vit</p>	<p>Komuna Donatorët</p>	<p>Publiku i informuar përmes sesioneve informuese përgjatë 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje</p>	<p>Strategjia Nacionale për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje Konventa e Stambollit (kapitulli III, nenet 7,12 dhe 13, kapitulli IV nenet 18,19)</p>
<p>4. Promovimi i modeleve pozitive të cilët sensibilizojnë opinionin publik që dhuna nuk tolerohet</p>	<p>Realizimi i video mesazheve dhe posterave nga persona pozitiv (adekuat *) dhe të dashur për publikun që shërbejnë si modele pozitive</p>	<p>Artist, Aktorë, Sportist</p>	<p>2024 2025 2026</p>	<p>200e për cdo vit</p>	<p>Donatorët</p>	<p>Më shumë gra e vajza, djem e burra të ndërgjegjësuar për mos e pranuar dhe mos e toleruar dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave</p>	<p>Strategjia Nacionale për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje Konventa e Stambollit (kapitulli III nenet 7, 12 dhe 13, kapitulli IV nenet 18,19)</p>

Objektivi strategjik –II- Fuqizimi institucional për mbrojtje dhe trajtim të viktimave

Treguesi: Numri i trajnimeve të realizuara për mekanizmat lokalë për veprimet e përbashkëta dhe efikase në parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave.

Rezultati i synuar: Mekanizmat koordinues lokal të ngritur, funksional dhe efikas në zbatimin e veprimeve për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave.

Objektivi specifik: Fuqizimi i Mekanizmit Koordinues Lokal për menaxhimin e rasteve të dhunës

Treguesi: Buxhet i mjaftueshëm në dispozicion për funksionimin e Mekanizmave Koordinues në nivel lokal

Rezultati i synuar: Komuna e Kamenicës ndan buxhet për të mundësuar koordinim dhe monitorim efikas të veprimeve kundër dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave

Aktiviteti	Veprimet	Institucioni të cilit i kërkohet përkrahje /bashkëpunim	Data e zbatimit	Kosto	Burimi i Financimit	Rezultati i dëshiruar/ i pritshëm	Dokumenti Strategjik është në pajtueshmëri aktiviteti në fjalë
1. Vënia në dispozicion e mjeteve të mjaftueshme financiare për funksionimin e MKKDHF në nivel lokal	Mbajtja e takimeve të rregullta të MKKDHF për të qenë efektiv dhe efikas në punët e tyre	Komuna MKKDHF	2024 2025 2026	600e për cdo vit	Komuna Donatorët	Mbulimi i kostos së Koordinimit dhe aktiviteteve të Mekanizmave Koordinues nga buxheti vjetor i Komunës	Konventa e Stambollit

<p>2. Ngritja/fuqizimi i kapaciteteve të anëtarëve të MKKDFH përmes trajnimeve periodike për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, përmes qasjes shumë sektoriale të koordinuar</p>	<p>Organizimi i trajnimeve periodike për ngritje të kapaciteteve të profesionistëve</p>	<p>Ministritë Komuna Donatorët</p>	<p>2024 2025 2026</p>	<p>500e (për një takim dhe eksperti)</p>	<p>Qeveria Komuna Donatorët</p>	<p>Profesionistë të aftësuar në të gjitha fushat për të trajtuar në mënyrë adekuate dhe me përgjegjshmëri rastet e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave</p>	<p>Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje Konventa e Stambollit (neni 7)</p>
<p>3. Sigurimi i mjeteve të nevojshme për transport të menjëhershëm dhe adekuat të viktimave Mjete transporti për Policinë e QPS.</p>	<p>Sigurimi i mjeteve të transportit për efikasitet në punë</p>	<p>Qeveria Komuna Donatorët</p>	<p>2024 2025 2026</p>	<p>////////</p>	<p>Qeveria Komuna Donatorët</p>	<p>Transporti i viktimave sipas nevojës, i kryer në kohë dhe me mjete të përshtatshme</p>	<p>Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje Konventa e Stambollit</p>
<p>5. Sigurimi i mjeteve për fondin emergjent për nevojat e viktimave të dhunës në familje</p>	<p>Planifikimi i mjeteve dhe mënyra e krijimit të fondit i cili do të shërbejë viktimave të dhunës në familje për nevojat e qastit</p>	<p>Komuna Donatorët</p>	<p>2024 2025 2026</p>	<p>500e për çdo vit</p>	<p>Komuna Donatorët</p>	<p>Institucionet në të cilat paraqiten viktimat e dhunës të familje: (Policia, QPS) në dispozicion fondin emergjent për mbulimin e shpenzimeve që dalin si nevojë aty për aty.</p>	<p>Konventa e Stambollit</p>

Objektivi strategjik – III - Rehabilitimi dhe riintegrimi i qëndrueshëm i viktimave

Treguesi: Përqindja e buxhetit vjetor dedikuar funksionimit të qendrave të shërbimeve mbështetëse të specializuara për të gjitha format e dhunës.

Rezultati i synuar: Funksionimi i qendrave të shërbimeve mbështetëse të specializuara për të gjitha format e dhunës mbështetet me buxhetin e nevojshëm nga qeverisja lokale.

Objektivi specifik: Ngritja dhe fuqizimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për viktimat e mbijetuara

Treguesi: Numri i shërbimeve mbështetëse të specializuara për të mbijetuarit e dhunës, të ngritura apo të zgjeruara, sipas llojit të shërbimit (strehimoret, linjat telefonike të ndihmës, qendra të trajtimit të sulmeve seksuale etj).

Rezultati i synuar: Shërbime mbështetëse të specializuara për të mbijetuarat/mbijetuarit e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, të ngritura dhe funksionale në përputhje me kërkesat/standartet e Konventës së Stambollit.

Objektivi specifik: Zbatimi i politikave të integruara që mundësojnë riintegrim afatgjatë e të qëndrueshëm të viktimave/mbijetuarave/mbijetuarve të dhunës

Aktiviteti	Veprimet	Institucioni të cilit i kërkohet përkrahje/b ashkëpunim	Data e zbatimit	Kosto	Burimi i Financimit	Rezultati i dëshiruar/ i pritshëm	Dokumenti Strategjik është në pajtueshmëri aktiviteti në fjalë
1. Avokimi në nivel qëndror dhe lokal për rritjen e fondeve të	Takime avokuese me perfaqësues	MD, MFPT Komuna MKKDFH	2024 2025 2026	///////	MFPT, MD Komuna, Donatorët	Rritja e buxhetit dhe fonde të qëndrueshme	Ligjin për Mbrojtjen e viktimave të

nevojshme /domosdoshme	komunal, qendrore dhe donator për realizimin e kërkesave për krijimin e buxhetit të qëndrueshëm						dhunës në familje Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen ng Dhuna në Familje Konventa e Stambollit
2. Shtimi i burimeve njerëzore, punësimi i psikologëve, interoretuesin e gjuhës së shenjave, punëtorëve social dhe stafin përkatës në institucionet publike dhe OJQ në proporcion me numrin e banorëve në Komunë.	Avokim në arritjen e kërkesave për punësimin e psikologëve në shkolla dhe punëtorëve social në institucionet publike e OJQ	MD Komuna Donatorët	2024 2025 2026	Nevojiten 2 psikolog në QPS Interpretuesin e gjuhës së shenjave	Qeveria Komuna Donatorët	Përmbushja e standardeve minimale profesionale dhe strukturore	Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje Konventa e Stambollit Ligji për Zyrtarë Publik
3. Mbështetja e strehimoreve me fonde 3 vjeçare (sipas afatit të licencimit të OJQ)	Ndarja e fondeve në bazë të marrëveshjeve me OJQ, Strehimore	Komuna Donatorët	2024 2025 2026	5000e cdo vit	Qeveria Komuna Donatorët	Strehimore të mbështetura në terma infrastrukturorë e financiarë	Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje Konventa e St.

<p>4. Mbështetja financiare e shërbimeve të këshillimit psiko – social të ofruar në institucionet publike ose në OJQ të specializuara</p>	<p>Punësimi i një psikologeje klinike në QKMF</p>	<p>Komuna</p>	<p>2024 2025 2026</p>	<p>Psikologe klinike</p>	<p>Qeveria Komuna Donatorët</p>	<p>Shërbim i specializuar i këshillimit psiko – social i përshtatut me nevojat e grupeve të veçanta</p>	<p>Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje Konventa e Stambollit</p>
<p>5. Dizajnimi i programeve të reja në përputhje me nevojat e identifikuar për zhvillim të shkathtësive dhe përshtatja e programeve aktuale për aftësim profesional</p>	<p>Identifikimi i nevojave për zhvillim të shkathtësive profesionale</p>	<p>Qeveria Donatorët Komuna Qendra e Aftësimit Profesional</p>	<p>2024 2025 2026</p>	<p>////////</p>	<p>MFPT Komuna Donatorët</p>	<p>Programe të konsoliduara për aftësim profesional</p>	<p>Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje Konventa e Stambollit</p>
<p>6. Zhvillimi i planit të banimit social trevjeçar në Komunë dhe planifikimi i banimit social për viktimat e DHF/DHBGJ, qiratë, ofrimi i banimit).</p>	<p>Të rregullohet qështja e banimit social dhe pagesa e qerasë së viktimave të DHF dhe DHBGJ, ofrimi i banimit</p>	<p>Komuna</p>	<p>2024 2025 2026</p>	<p>Vlerësimi</p>	<p>Komuna</p>	<p>Banimit social për viktimat i konsoliduar</p>	<p>Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje Konventa e Stambollit</p>

7. Krijimi i fondit për grante për punësim të viktimave të dhunës në familje	Avokim për krijimin e fondit	Komuna	2024 2025 2026	////////	Komuna MFPT MD	Fondi i krijuar	Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje Konventa e St
8. Krijimi i lehtësuarve për punëdhënësit /bizneset të cilat punësojnë kategoritë e ndjeshme të shoqërisë përfshirë viktimat e dhunës në familje	Punësimi i viktimave	MD MFPT Komuna	2024 2025 2026	Marrëveshja e komunës me QAP-in (për trajnime)	Qeveria Komuna MFPT MD MZHE	Punësimi i viktimave përmes programeve të ndryshme	Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje Konventa e Stambollit
9. Subvencionimi i pagesave për kopshte të fëmijëve të viktimave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.	Avokim në Institucionet komunale për realizimin e aktivitetit	Komuna DKA	2024	Kërkesë DKA për rregullimin e kësaj qështjeje	Komuna	Lehtësim për gratë viktime të dhunës në familje për qasje në punë dhe edukim të fëmijëve	Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024
10. Shkollimi joformal (pa pagesë) për viktimat e dhunës në familje	Lirimi pa pagesë për viktimat e e Dhunës në familje	Komuna DKA	2024 2025 2026	Kërkesë DKA-së	Komuna	Shkollimi fillor dhe mesëm i viktimave të dhunës në familje	Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje Konventa e Stambollit